



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39, al. 1 dhe nenit 40, al. 2, të Ligjit mbi tokën ndërtimore ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 14/80 dhe 42/86), nenit 3, al. 1, pika "b" të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, al. 1 pika "b" e Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2003 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR
STREHIMIN E FËMIJËVE TË BRAKTISUR DHE ATYRE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA, NË FSHATIN GRAÇANICË, KOMUNA E PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit, për strehimin e fëmijëve të braktisur dhe atyre me aftësi të kufizuara, në fshatin Graçanicë, komuna e Prishtinës.

Neni 2

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për strehimin e fëmijëve të braktisur dhe atyre me aftësi të kufizuara, në fshatin Graçanicë, komuna e Prishtinës.

Lokacioni, nga alinea 1. e këtij neni, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 17/1, fleta poseduese nr. 499, Komuna Kadastrale Graçanicë, në sipërfaqe prej 31.04 ari, pronë e Komunës.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për hartimin e projektit urbanistik të lokacionit, nga alinea 2 e nenit 2, të këtij Vendimi, në bazë të të cilit do të caktohen kushtet urbanistike-teknike, për lejimin e ndërtimit të objekteve investive, nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 4

Projekti urbanistik, nga neni 3 i këtij Vendimi, do të inkorporohet në planin e ardhshëm zhvillimor të komunës së Prishtinës dhe planin tjetër rregullativ për hapësirën e gjerë të zonës ku gjindet lokacioni, nga neni 2 i këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtorati i Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe Drejtorati i Financave dhe Pronës, të Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar, për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. NR. 353-2118 DT. 08.12.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri